



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

*KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, U.D. i menaxherit të Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; Dhe*

*GRUPI I O E "NIL ARCHITECTS" SHPK A&F CONSTRUCTION SHPK Komuna e Prishtinës , të cilën e përfaqëson I autorizuari z. Shkelzen Ademaj me Nr. Unik i Rexh. Biznesi, 811283944 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:*

### TITULLI I KONTRATËS:

#### RREGULLIMI I SALLËS SË TAKIMEVE

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-20-4964/ 5-2-1/ C426</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 020 / 067 / 521</i>

### Neni 1 Lënda

*1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:*

#### RREGULLIMI I SALLËS SË TAKIMEVE

### Neni 2 Çmimi

*2.1 Çmimi i punëve per aktivitetin e prokurimit: RREGULLIMI I SALLËS SË TAKIMEVE është: 29.890,00 dhe me fjalë:*

*/Njëzet e nëntë mijë e tetë qind e nëntëdhjetë e tetë zero euro €*

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Afati i përmbushjes së kontratës:**

4.1. Të gjitha punimet sipas kësajë kontrate do të përfundojnë brenda 30 ditëve, nga data e nënshkrimit të kontratës, e me se larti deri me 25.12.2020

### **Neni 5 Ndërprerja e kontratës:**

5.1 Kjo kontratë mund të shkëputet kurdo që kontraktori nuk i respekton kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës të parapara në dosjen e tenderit, dhe kur për një gje të tillë plotësohen këto kushte.

### **Neni 6 Komunikimet**

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës





me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për: Autoritetin Kontraktues:**  
**Komuna e Istogut**

**Për: Kontraktuesin:**  
**Nil Architects A & F Construction Shpk**

<b>Emri:</b>	<b>Gëzim Ademaj</b>	<b>Emri:</b>	<b>NER. Shkurte Sadiku</b>
<b>Pozita:</b>	<b>U.D. Menaxher-it të Prokurimit</b>	<b>Pozita:</b>	<b>P r o n a r e</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<b>26.11.2020</b>	<b>Data:</b>	<b>26.11.2020</b>
<b>Vu la</b>		<b>Vu la</b>	

## KOMUNA E ISTOGUT

## Rregullimi i Sallës së Takimeve

	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
--	----------------------	--------	-------	-----------------	-----------

## 1 Punet e dyshemese dhe punet tjera

1.1	Furnizimi dhe instalimi i pllakeve te qeramikes me dim 60x60,ose dimension tjetër sipas organit mbikqyres me prerje laserike. Tekstura dhe ngjyra sipas zgjedhjes së investitorit. Instalimi te behet me ngjites me baze cimentoje. Te punohen dhe mbushen fugat me gjeresi 2mm	m2	131	13.00	1,703.00
1.2	Mermetimidhe lyerja e radiatoreve	cope	4	20.00	80.00
1.3	Riparimi i dritareve ekzistuese izolimi i kandeve te dritareve	cope	4	50.00	200.00

## 2 Punet e inventarit

2.1	Furnizimi dhe instalimi i mveshjes se mureve dekoruese nga MDF sipas pozicioneve ne projekt M1	cope	1	1,000.00	1,000.0 €
2.2	Furnizimi dhe instalimi i mveshjes se mureve dekoruese nga MDF sipas pozicioneve ne projekt M2	cope	1	1,000.00	1,000.0 €
2.3	Furnizimi dhe instalimi i mveshjes se mureve dekoruese nga MDF sipas pozicioneve ne projekt M3	cope	1	1,000.00	1,000.0 €
2.4	Furnizimi dhe instalimi i mveshjes se mureve dekoruese nga MDF sipas pozicioneve ne projekt M4	cope	1	1,000.00	1,000.0 €
2.5	Furnizimi dhe instalimi i Tavinave sipas projektit POS 1	cope	10	90.00	900.0 €
2.6	Furnizimi me karrika sipas projektit	cope	90	50.00	4,500.0 €
2.7	Furnizimi dhe instalimi i deres nga MDF sipas projekti D1	cope	1	300.00	300.0 €

## 3 Punët e zërimit

3.1	<p><b>NJËSIA QENDRORE DIGJITALE E MIKROFONAVE</b></p> <p>Njësia qendrore e sistemit me funksionet e përthimit simultan, diskutimit të mundësor lidhjen me njësi zgjeruese të sistemit në të ardhmën</p> <p>Të furnizoj njësitë e mikrofonave sipas topologjisë në qark</p> <p>Të jetë i prodhuar sipas standardit IEC 60914 i aplikueshëm në sistemet e tilla</p> <p>Procesim digjital i të dhënave</p> <p>Të përkrah protokolet e komunikimit TCP/IP për kontrol dhe monitorim nga kompjuteri</p> <p>Për çdo njësi të delegatit të përcaktoj nga një ID individuale dhe unike</p> <p>Të ofroj mënyra të komunikimit sipas parimeve: numrit të delegatëve që lejohen të flasim; të kufizoj kohën e foljes nga 1 deri 240min;</p> <p>Të mundësoj delegatëve aktivizimin e mikrofonave sipas parimit të metodës së hapur (të jenë më shumë se dy mikrofonave që mund të jenë njëkohësisht të hapur)</p> <p>Të mundësoj delegatëve aktivizimin e mikrofonave sipas parimit FIFO (me aktivizimin e mikrofonit në mënyrë automatike deaktivizon mikrofonin e parafolësit)</p> <p>Të mundësoj delegatëve aktivizimin e mikrofonave me Zë (sipas ndjeshmërisë dhe nivelit të zërit)</p> <p>Të ketë funksion të pavarur të punës (nga kompjuteri)</p> <p>I pajisur me LCD ekran në të cilën duhet shfaqur gjendja dhe metoda e punës së njësisë qendrore</p> <p>Të ketë butonat për konfigurim manual të njësisë</p> <p>Të ketë së paku dy hyrje dhe dalje për audio</p> <p>RS232 portin për lidhje me sistemin qendror dhe diagnostifikim</p> <p>Së paku një port RJ45 për lidhje me LAN</p> <p>USB port për ruajtjen e shënimeve dhe instalimin e softuerit (upgrade)</p> <p>Furnizimi i tensionit 220~240VAC, shpenzimi të mos tejkalojë 250W</p> <p>Të jetë i montueshëm në rack cabinet 19" (të përshihen mbajtësit për montim)</p> <p>Të ketë së paku 2 vite garancion</p>	cope	1	900.0 €	900.0 €
3.2	<p><b>MIKROFON DIGJITAL I KRYESUESIT</b></p> <p>Njësia digjitale e mikrofonit duhet të jetë i prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare IEC60914</p> <p>Duhet të përkrah topologjinë e lidhjes në qark (daisy chain)</p> <p>Duhet të jetë i montueshëm mbi sipërfaqe të tavolinës</p> <p>Të jetë i paisur me altoparlantë të integruar dhe kualitativ</p> <p>Të jetë imun ndaj interferencave elektromagnetike dhe telefonave mobil</p> <p>Të jetë i paisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme</p> <p>Të ketë prioritet absolut mbi mikrofonat tjerë në qark</p> <p>Të ketë buton për deaktizimin e mikrofonave në qark</p> <p>Të ketë mundësinë e aprovimit të kërkesës për marrjen e fjalës nga pjesëmarrësit në panel</p> <p>Të jetë i pajisur me mikrofon me qafë gjysëm të lakueshëm dhe unazë të ndritshme</p> <p>Të ketë kablo të integruar për lidhje ne qark me mikrofonin pasues</p> <p>Të ketë së paku 2 vite garancion</p>	cope	1	550.0 €	550.0 €

	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
3.3	<p><b>MIKROFON DIGJITAL I DELEGATIT</b> Njësia digjitale e mikrofonit duhet të jetë i prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare IEC60914 Duhet të përkrah topologjinë e lidhjes në qark (daisy chain) Duhet të jetë i montueshëm mbi sipërfaqe të tavolinës Të jetë i paisur me altoparantë të integruar dhe kualitativ Të jetë imun ndaj interferencave elektromagnetike dhe telefonave mobil Të jetë i paisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme Të ketë buton për aktivizimin e mikrofonit Të jetë i pajisur me mikrofon me qafë gjysëm të lakueshëm dhe unazë të ndritshme Të ketë kablo të integruar për lidhje në qark me mikrofonin pasues Të ketë së paku 2 vite garancion</p>	copë	14	120.0 €	1,680.0 €
3.4	<p><b>KONZOLLA DIGJITALE E PËRKTHYESIT SIMULTAN</b> Konzolla për përkthim simultan duhet të jetë e formatit digjital dhe i prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare IEC60914, ISO2603 dhe ISO4043 Të jetë i pajisur me ekran grafik (LCD) që duhet të shfaq të dhënat e konfigurimit, numrin dhe gjuhën e kanalit në hyrje dhe dalje, mesazhet e shkurtëra, orën, etj Të ketë të altoparantë të integruar me kualitetit të lartë Të ketë mundësinë e akordimit të nivelit të zërit Të ketë mundësinë e çaktivizimit automatik të altoparantit në rast se lëshohet (aktivizohet) mikrofonin i përkthyesit Të ketë mundësinë e akordimit të nivelit të ndjeshmërisë së mikrofonit Të ketë butonin dhe funksionin për përsëritje (repeat function) Të mundësojë përkthimin nga kanali origjinal ose nga kanalet tjera përkthyesive sipas formës rele (relay function) Të jetë i pajisur me buton për rele për përzgjedhje të shpejtë në përkthim Të ketë mundësinë e emërtimit sipas gjuhës për secilin kanal që përkthehet (psh. 1.albanian, 2.english, 3.turkish, 4.serbian, etj) Të ketë butonin dhe funksionin e heshtjes (mute) së mikrofonit gjatë përkthimit Të ketë filtër të integruar për eliminimin e elementeve penguese nga frekuencat e ulta Të ketë funksionin për fjalim më të ngadalshëm, nëse përkthyesi nuk mund ta përcjell folësin, paralajmëron që të flas më ngadal (slow function) Të ketë së paku pesë butona konfigurues a,b,c,d,e për gjuhët që përkthehen përmes funksionit me rele, me indikator që tregojnë se cili buton është aktiv Të ketë butonin për aktivizimin e mikrofonit Të jetë i pajisur me mikrofon elektret të kondensuar me qafë të lakueshme dhe unazë të ndritshme kur është aktiv (preferohet që unaza të jetë e ndritshme me ngjyrë të kuqe) Të jetë i pajisur me port për lidhje të kufjeve për përkthyes, preferohet porti standard 3.5mm dhe 6.4mm Të jetë i pajisur me kablo të integruar për lidhje në seri me konzollat tjera të përkthimit Të ketë së paku 2 vite garancion</p>	copë	2	1,050.0 €	2,100.0 €
3.5	<p><b>KUFJE PROFESONALE PËR PËRKTHYES</b> Kufje profesionale mikrokombinacion me mikrofon Të jenë stereo kufje Të ketë kablo me konektor adekuar për lidhje në portin e konzollës së përkthimit Të ketë së paku 2 vite garancion</p>	copë	2	250.0 €	500.0 €
3.6	<p><b>NJËSIA QENDRORE DIGJITALE TRANSMETUESE</b> Njësia qendrore digjitale me rreze infra të kuqe dhe me funksione të transmetimit të kanaleve për përkthim simultan Të jetë i prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare IEC61603-7 dhe IEC 60914 (standarde që aplikohen në fushën e sistemeve konferenciale) Të ketë së paku 4 kanale për përkthim simultan Të bëjë eliminimin automatik të pengesave që mund të shkaktohen nga sistemet e ndriqimit Të operojë në brezin frekuencor nga 2 MHz deri 8 MHz Të mundësojë emërtimin e secilit kanal për përkthim sipas gjuhës që përkthehet Të ketë mundësinë e akordimit të ndjeshmërisë për secilin kanal Të bëjë sinkronizimin automatik të numrit të kanaleve që janë në shfrytëzim Të jetë i pajisur me LED transmetim në pjesën e përparme të paisjes që të mundësojë monitorimin e transmetimit IR nga personeli teknik brenda dhomës së paisjeve Të jetë i pajisur me ekran LED në të cilën shfaqet gjendja dhe metoda e punës së njësive qendrore Të ketë së paku dy dalje dhe hyrje për audio sinjale Të ketë port të veçantë për lidhje me njësi tjera IR dhe diagnostifikim të saj Të ketë port për lidhje me rrjet lokal (LAN) Të ketë port për USB për ruajtje të të dhënave teknike dhe përditësimin e softuerit të njësive qendrore Të ketë port për lidhje të konzollave të përkthyesve Të ketë port për lidhje me paisje emergjente Të ketë port për lidhje të kufjeve për monitorim të audio sinjalit Të operojë në brezin e tensionit 220VAC-240VAC Të jetë i montueshëm në rack kabinet 19" – të përfshihet pjesët montuese për rack kabinet Të ketë së paku 2 vite garancion</p>	copë	1	820.0 €	820.0 €

	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
3.7	<p><b>RADIATOR IR DIGJITAL</b>  Radiatori digjital duhet të mundësoj emetimin e sinjalit audio përmes rrezeve infra të kuqe që transmetohen nga njësia qendrore  Të jetë kompatibil për lidhje me njësinë qendrore (nr.1)  Të jetë i prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare IEC61603-7 dhe IEC 60914 (standarde që aplikohen në fushën e sistemeve konferenciale)  Të jetë shumë kanalesh, së paku 32 kanale shpërndarëse  Të mos konsumojë energji më shumë se 35W  Të ketë fuqi emetuese së paku 15W  Të mbulojë hapësirën deri 30 metra me rreze infra të kuqe  Të ketë funksionin për kyçje dhe çkyçje (on/off) të sinkronizimit me njësinë qendrore  Të ketë mundësinë e lidhjes në seri me radiatorët tjerë  Të jetë i pajisur me indikator për mbrojtje nga temperatura  Të ketë mundësinë e kontrollit automatik të temperaturës, në rast të ngritjes së temperaturës atëherë radiatori të kalojë në regjimin e punës për emetimin me gjysmën e kapacitetit emitues  Të ketë funksionin e kompensimit për vonesat kohore  Të ketë mundësinë e përcaktimit të kapacitetit emitues (të plotë ose gjysmak) përmes ndërprerësit të qarkut në radiator  Të ketë modulim DQPSK sipas standardit IEC 61603-7  Të ketë ftohje natyrale – pa ventilator  Të operojë në brezin e tensionit 220VAC-240VAC  Të ketë sinjal HF nominal në hyrje 1Vpp, min.10mVpp, resistencë 75Ohm  Të ketë sinjal në dalje 1Vpp, 6VDC, resistencë 75Ohm  Të jetë i montueshëm në muri apo tavan – të përfshihet mbajtësi për montim  Të ketë së paku 2 vite garancion</p>	copë	2	1,250.0 €	2,500.0 €
3.8	<p><b>PRANUES IR DIGJITAL</b>  Pranues digjital me rreze infra të kuqe  Të mundësoj pranimin e sinjalit nga kanalet e përkthimit simultan  Të jetë i prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare IEC61603-7 dhe IEC 60914 (standarde që aplikohen në fushën e sistemeve konferenciale)  Të ketë së paku 4 kanale pranuese  Të jetë i pajisur me ekran që shfaq numrin e kanalit, gjuhën, nivelin e baterisë, gjendjen e sinjalit  Të jetë i pajisur me selektor të kanalit (poshtë/lartë)  Të ketë mundësinë e shfaqjes së kanaleve të disponueshme aq sa përdoren në sistem (nga njësia qendrore)  Të ketë mundësinë e pranimit të sinjalit në këndin 270°  Duhet që përdoruesit t'ja mundësoj lëvizje dhe qëndrim (pozitë) të lirë  Të jetë i mbrojtur nga interferencat qofshin ato nga dritat apo rrezet e diellit  Të jetë i pajisur me së paku një port për lidhjen e kufjeve  Të ketë funksionin e çkyçjes automatike të pranuesit në rast se nuk ka sinjal nga radiatori apo nëse kyçjet hiqen nga porti  Të ketë mundësinë e reagimit brenda brezit frekuencor nga 20Hz deri 10kHz  Të ketë mundësinë e operimit përmes baterive rimbushëse apo alkaline  Të ketë qark të integruar me precizitet të lartë kontrollues për rimbushjen e baterisë  Të ketë së paku 2 vite garancion</p>	copë	30	128.0 €	3,840.0 €
3.9	<p><b>BATERI RIMBUSHËSE PËR PRANUES IR</b>  Bateri rimbushëse (pako) kompatibil me pranuesin me rreze infra të kuqe  Të jenë të prodhuara nga materiali Ion Litium ose Nikel Metal Hibrid  Të ketë kapacitet deri 1500mAh  Të ketë tension 3.7V</p>	copë	30	40.0 €	1,200.0 €

	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
3.10	<b>KUFJE PROFESIONALE PËR PRANUES IR</b> Kufje profesionale stereo për lidhje me pranuesin digjital Të jetë i pajisur me dy altoparlante (stereo) nga 32Ohm secili Të ketë sfungjer për mbrojtje Të ketë mundësinë e reagimit brenda brezit frekuencor nga 20Hz deri 20kHz Të ketë ndjeshmëri ≥108 dBA në 1mW Të ketë së paku 2 vite garancion	copë	30	68.0 €	2,040.0 €
3.11	<b>KUTI PËR KARIKIMIN E PRANUESVE IR</b> Kutia për karikimin e baterive dhe bartjen/akomodimin e pranuesve digjital Të ketë së paku 60 slote për karikim dhe akomodim të pranuesve digjital Të bëjë karikimin e të gjitha baterive në të njëjtën kohë Të jetë i pajisur me ushqyes të tensionit sipas metodës automatike të kalimit të tensionit (i brendshëm – nuk pranohet që ushqyesi i tensionit të jetë ndaras nga kutia) Të jetë i pajisur me ndërperës të tensionit Kutia duhet të jetë e pajisur me kapak dhe dorëz për bartje të saj Të ketë së paku 2 vite garancion	copë	1	950.0 €	950.0 €
3.12	<b>AMPLIFIKATOR DIGJITAL</b> Amplifikator që operon në teknogjinë digjitale, e klasit D Të ketë fuqi 200W Të operojë në 8/4Ohm dhe 70/100V Të operojë në modin e punës në stereo, mono dhe zonal Të ketë së paku 2 kanale audio në dalje Të ketë funksionin bluetooth, të integruar, për audio në hyrje Të ketë së paku dy hyrje stereo Të ketë së paku dy hyrje për mikrofon Të jetë i menaxhueshëm dhe kontrollueshëm përmes web browser Të ketë interfejs për kyqje në rrjet RJ45 Të ketë port USB dhe 3.5mm për kontroll të zërit ose lidhjen e paisjeve të jashtme Të ketë funksion mbrojtës nga lidhja e shkurtërt, mbingarkesa, temperatura e lartë, DC Të ketë reagim në brezin frekuencor nga 30Hz deri 20kHz Të ketë ushqyes tensioni nga 110V/240VAC, 50/60Hz Të ketë së paku 2 vite garancion	copë	1	370.0 €	370.0 €
3.13	<b>ALTOPARLANT</b> Të jetë i montueshëm në muri Të ketë mundësinë e montimit në pozitë horizontale dhe vertikale Të jetë 8Ohm ose 4Ohm Të ketë fuqi minimum 40W Të ketë së paku 2 vite garancion	copë	2	55.0 €	110.0 €
3.14	<b>MIKROFON AJROR (PA TELA)</b> Mikrofon pa tela që operon në brezin frekuencor UHF, PLL Të operojë në brezin UHF Nga baza e mikrofonit të operojë mikrofonin deri 50 metra distancë Të jetë mikrofon i trupit për ligjerues dhe i dorës Të ketë mundësinë e përzgjedhjes së kanaleve nga operatori, së paku 120 kanale Të ketë mundësinë e skenimit automatik të kanalit Të jetë i pajisur me antena, preferohet së paku 2 antena për mbulueshmëri më të mirë Të ketë sinkronizim IR Të lidhet me njësinë qendrore digjitale Të ketë së paku 2 vite garancion	copë	1	247.0 €	247.0 €
3.15	<b>KABLLIMI</b> Kabllot adekuate lidhje të sistemit dhe zërimit	paushall	1	300.0 €	300.0 €
3.16	<b>INSTALIMI</b> Montimi, instalimi dhe konfigurimi i sistemit	komplet	1	100.0 €	100.0 €
<b>REKAPITULIMI</b>					
<b>1</b>	<b>Punet e dyshemese dhe punet tjera</b>				<b>1,983.0 €</b>
<b>2</b>	<b>Punet e inventarit</b>				<b>9,700.0 €</b>
<b>3</b>	<b>Punët e zërimit</b>				<b>18,207.0 €</b>
<b>TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT</b>					<b>29,890.0 €</b>